



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.1675/20

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, divizioni civil me gjyqtaren Fatbardha Uka Ibrahimimi, në çështjen juridike të paditësit Radiotelevizioni i Kosovës (RTK), Prishtinë, kundër të paditurit Agron Demi nga Prishtina, Rr. "Sejdi Kryeziu", Blloku 4, nr.4, për shpifje dhe fyerje, jashtë seance me datën 22.09.2021, mori këtë;

AKTVENDIM

- I. DETYROHET Agron Demi nga Prishtina, që ne afat prej 15 ditësh, nga dorëzimi i padisë me te gjitha shkresat të cilat i janë bashkangjitur këtij aktvendimi, ti paraqesin gjykatës përgjigje ne padi ne forme te shkruar ne 2 ekzemplare, nen kërcënimin e pasojave procedurale.
- II. I padituri është i detyruar qe ne përgjigje ne padi ti paraqes prapësimet procedurale dhe te deklaroj se e pranon apo e konteston kërkesëpadinë e paditësit. Në qoftëse i padituri e konteston kërkesëpadinë e paditësit, përgjigjja ne padi duhet ti përmbaj faktet mbi te cilat i padituri i bazon thëniet e tij dhe provat me te cilat provohen faktet e paraqitura. Përgjigjja ne padi duhet ti përmbaj te gjitha elementet e parapara me dispozitat e nenit 99 te LPK.
- III. Ne qoftëse, përgjigjja ne padi është e pakuptueshme apo jo e plote me qellim te eliminimit te këtyre të metave, gjykata do te veproi ne pajtim me dispozitat e nenit 102 te LPK.
- IV. Paralajmërohet i padituri se në qoftëse brenda afatit te caktuar si ne al. I te këtij aktvendimi nuk e paraqesin përgjigjen ne padi, atëherë gjykata do te merr aktgjykim për shkak te padegjueshmërisë-mosbindjes poqëse plotësohen kushtet e parapara me dispozitat e nenit 150 al. 1 pika a, b dhe c e LPK- se.
- V. Personi i cili paraqitet si përfaqësues ligjor është i detyruar qe me rastin e ndërmarrjes se veprimit te pare procedural te provon cilësinë e përfaqësuesit ligjor, ndërsa i autorizuari me ndërmarrjen e veprimit te pare procedural është i detyruar qe gjykatës t'ia paraqes autorizimin e rregullt.

A r s y e t i m

Gjykatësi i çështjes ne pajtim me dispozitat e nenit 394, 395, al. 1 dhe 2, 396, 397, 99, 102, 150 al. 1 pika 9 (a) (b) dhe (c) 77 al.2,93 al. 1 dhe 387 al. 1 pika (a) e LPK- se vendosi si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GYKATA THEMELORE PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil  
C.nr.1675/20, me datën 22.09.2021

Gjyqtarja,  
Fatbardha Uka Ibrahimimi



UDHEZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

**GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË****Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

PADITËSI: Radiotelevizioni i Kosovës (RTK), rr. "Xhemajl Prishtina", nr. 12, Prishtinë

I PADITURI: Agron Demi, analist politikash, me adresë të vendit të punës rr. "Sejdi Kryeziu", Blloku 4, nr.4, 10000, Prishtinë

**PADI PËR SHPIFJE DHE FYERJE****1. SHPIFJA DHE FYERJA**

I padituri, Agron Demi, në rrjetin e tij social facebook publikisht ka bërë shpifje dhe fyerje kundrejt RTK-së, si dhe punonjësve të saj, me ç'rast, siç do të dëshmohet më tej, është dëmtuar në masë të konsiderueshme reputacioni i RTK-së.

Qeveria e Republikës së Kosovës, është fakt notor se pas paraqitjes së virusit COVID – 19 në Kosovë, ndërmorri një varg masash me qëllim të parandalimit të përhapjes së këtij virusi, dhe në këtë situatë të jashtëzakonshme, i padituri në rrjetin e tij social facebook, me datë 13.03.2020 ka deklaruar publikisht se, citoj:

*"E kisha shtu edhe një masë për ruajtjen e shëndetit: **mbylljen e menjëhershme të RTK.***

*Nëse televizioni publik nuk arrinë me qenë me publikun as në këso rastesh, po me na infektu me propagandë të fliqtë, ku është arsyeja me ekzistë një medium publik? Me qato 11 milionë euro, blejmë maska e dezinfektues të duarve për 2 milionë banorë."*

**PROVË:** Deklarata/Postimi i të paditurit i datës 13.03.2020

RTK nuk ka pranuar zyrtarisht asnjë ankesë nga palët kompetente dhe as nga palët që kanë interes juridik për paraqitje të ankesës, lidhur me mundësinë e mosveprimit të RTK-së në përputhje me kushtet e licencës, kodit të sjelljes, dhe akteve tjera juridike përkatëse gjatë raportimit të zhvillimeve të fundit, respektivisht në kohën kur i padituri deklarohet për "mbylljen

NR. SHKR. BR. SPISA  
2020 APR 27 PM 1:44  
OSNOVNI SUD  
PRISHTINE, PRISHTINA  
PRANILAT DOKUMENTI



e menjëhershme të RTK-së”. Andaj, është e papranueshme dhe e patolerueshme kjo gjuhë e urrejtjes e përdorur nga i padituri kundrejt paditësit, duke shkuar aq larg sa të kërkojë madje edhe mbylljen e Transmetuesit Publik të Kosovës.

Pas publikimit të kësaj deklarate, i padituri ka vazhduar me shpifje dhe fyerje kundër paditësit dhe punonjësve të saj, duke deklaruar fakte të pavërteta dhe skajshmërisht të dëmshme. Përmes rrjetit social facebook me datën 14.03.2020, i njëjti është shprehur se, citoj:

*“... jo veç me e mbyllë, por një repart burgu me mbushë me të gjithë ata që kanë zhvatë miliona euro prej RTK e janë përgjegjës për punësime pa asnjë kontrollë...”*

*RTK-ja nuk u nënshtrohet as vendimeve të Komisionit të Pavarur të Mediave, as opinioneve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, e as kërkesave të Kuvendit për llogaridhënie buxhetore...”*

**PROVË:** Deklarata/Postimi i të paditurit i datës 14.03.2020

Ligji NR. 02/L-65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes në nenin 3, pika a ka përkufizuar shpifjen, citoj: *“Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.”* Në rastin konkret, i padituri fare mirë e ka ditur se faktet për të cilat deklarohet janë të pavërteta, asgjë tjetër përveçse shpifje, dhe njëkohësisht ka qenë i vetëdijshëm se të njëjtat e dëmtojnë rëndë reputacionin e RTK-së.

I padituri ka vazhduar edhe më tutje të bëjë deklarata fyese me datë 04.04.2020, siç vijon:

*“... Përveç që i han rreth 12 milionë euro në vit, shantazhon dhe është burim i korrupsionit që krahasohet me PTK, televizioni publik është një ndër rrezikuesit më të mëdhenj të sigurisë publike.*

*Aman mbylleni dhe në vend të një medium publik, krijoni program publik, ku të gjitha mediat tjera munden me apliku dhe me transmetu tema në interes të publikut.”*

**PROVË:** Deklarata/Postimi i të paditurit i datës 04.04.2020

Me këtë deklaratë, i padituri ka fyer rëndë paditësin dhe punonjësit e tij, duke publikuar deklaratë nënçmuese pasi, sipas definicionit ligjor të termit “Fyerje” të përcaktuar në nenin 3

pika b të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes: *“Fyerja nënkupton deklarinimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese.”*

Pastaj pason deklarata tjetër e bërë më 05.04.2020, siç shprehet:

*“RTK-në nuk guxojmë me e injor. Edhe pse gjithnjë e më pak e shikojmë, RTK-në gjithnjë e më shumë po paguajmë nga taksat tona.*

*Një kohë kam avoku për me ndryshu mënyrën e financimit të RTK, me e nxjerr nga buxheti dhe me u finance direct nga qytetarët ngase kam mendu se kështu mund të nxirret nga kthetrat e partive. Tash mendoj se RTK duhet me u MBYLLË. RTK nuk mund të shpëtohet...*

*Andaj, ku është qëllimi me vazhdu me funksionu RTK?”*

**PROVË:** Deklarata/Postimi i të paditurit i datës 05.04.2020

Në këtë periudhë jo të zakonshme, kur punonjësit e RTK-së bëjnë të pamundurën për të raportuar për gjendjen aktuale, për të cilën punë madje duhet të përgëzohen, të njëjtit fyhen nga i padituri në mënyrën më të ulët të mundshme nga deklaratat e njëpasnjështme të cilat do ia bashkangjesim kësaj padie.

## 2. PËRGJEGJËSIA

I padituri është përgjegjës për shpifjet dhe fyerjet e dëshmuara në pjesën e parë të kësaj padie. Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, gjegjësisht neni 5, paragrafi 1, thotë qartë se:

*“Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj.”*

Në këtë mënyrë, dispozitat e nenit 9 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes sa i përket imunitetit, nuk e përjashtojnë përgjegjësinë e të paditurit. Pra, padituri është plotësisht përgjegjës për shpifjet dhe fyerjet e argumentuara me provat e prezentuara nga paditësi.



### 3. DËMI I SHKAKTUAR

Me deklaratat e lartcekura, i padituri, falë keqpërdorimit të pozitës së tij si analist politikash përmes së cilës ka ndikim të madhë tek publiku kosovar, ka krijuar një kampanjë kundër paditësit, duke shpifur dhe fyer atë. Kësaj kampanje, i padituri i ka kushtuar disa deklarata radhazi përgjatë një muaji, duke e konsoliduar në këtë mënyrë edhe më fuqishëm argumentimin shpifës dhe fyes se paditësi RTK “duhet të mbyllet”. Kësisoj, shpifja dhe fyerja, në rrjetin social facebook në të cilin ka afërsisht pesëmijë (5000) shokë – ndjekës, e po ashtu, cilido person tjetër mund të ketë qasje në facebook-un e tij, e cila mundëson krijimin e një rrjeti më të gjerë të shpërndarjes dhe qasjes në deklaratat/postimet e tij, i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm jomaterial në formën e cenimit të rëndë të reputacionit publik, nxitjes së dhunës kundër RTK-së dhe fyerjes publike.

Ligji Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës në nenin 3, paragrafi 2 ka përcaktuar si në vijim: *“RTK është person juridik jo profitabil me status të institucionit të pavarur publik me rëndësi të posaçme i cili ofron shërbim publikut në fushën e veprimtarisë mediale, të përcaktuar me këtë ligj dhe aktet tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore.”* Në këtë fazë, kur paditësit i është zvogëluar buxheti me të cilin i rrezikohet funksionimi i mirëfilltë, e po ashtu kur është në pritje të gjatë për miratimin e ligjit të tij, i padituri ka përdorur fjalor nxitës, duke thënë se RTK duhet të mbyllet, fjalor ky i cili nxitë urrejtje dhe dhunë tek publiku i gjerë karshi RTK-së.

Përderisa në rastin konkret nuk ekziston asnjë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë konform Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, në mbështetje të nenit 4 dhe nenit 14 të po këtij ligji, paditësi e parashtron këtë padi dhe i propozon Gjykatës që pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të merr këtë:

### AKT GJYKIM

**VËRTETOHET** se i padituri Agron Demi ka bërë shpifje dhe fyerje ndaj paditësit, me rastin e publikimit të deklaratave për RTK-në në rrjetin e tij social facebook.



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS  
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA  
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

**OBLIGOHET** i padituri Agron Demi që të kërkojë falje publike dhe t'i tërheqë deklaratat shpifëse dhe fyese ndaj RTK-së, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi.

**OBLIGOHET** i padituri Agron Demi t'i ndalë shpifjet dhe fyerjet dhe të premtojë se shpifja dhe fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen.

Ngadhnjim Kastrati,

Prishtinë, më 15.04.2020

Drejtor i Përgjithshëm i RTK-së

*Ngadhnjim Kastrati*







Agron Demi

13 Mar at 23:43 · 🌐

E kisha shtu edhe një masë për ruajtjen e shëndetit: mbylljen e menjëhershme të RTK.

Nëse televizioni publik nuk arrinë me qenë me publikun as në këso rastesh, po me na infektu r propagandë të flliqtë, ku është arsyeja me ekzis një medium publik? Me gato 11 milionë euro, blejmë maska e dezinfektues të duarve për 2 milionë banorë.







Agron Demi

Timeline ▾

Recent ▾

+ Add Friend



Agron Demi

March 14 · 🌐

Pas këtij reagimi të këtyre pakurrtzorëve, një korrigjim: jo veç me e mbyl një raport burgu me mbushë me të gjithë ata që kanë zhvatë miliona eu RTK e janë përgjegjës për punësime pa asnjë kontrollë.

Edhe nuk është që një emision nuk më ka pëlqy e po baj thirrje me mby qysh po thuhet në reagim. Është komplet mënyra e menaxhimit e politit redaktoriale e këtij mediumi qe 12 vjet.

Ashtu siç dëshmojnë raportet e auditimit, RTK-ja është një ndër keqpër më të mëdhenj të parastë publike. Në jo pak raste ky medium ka shërby si mjet lincimi për këdo që ka dalë kundër politikës redaktoriale të saj, e edhe për kritikuesit e pushtetit.

RTK-ja nuk u nënshtrohet as vendimeve të Komisionit të Pavarur të Më as opinionëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, e as kërkesave të Kuvë llogaridhënie buxhetore.

E këta pakurrtzorët që kanë reagu, në vend se me kontrollu kush po mi 'share' e 'like' statusat, kish qenë mirë me i numëru keqpërdorimet në r e auditortit për RTK.



Life Events



Started New Job at  
Instituti GAP

December 2016



Started New Job at  
Prishtina Insight

April 2016





Agron Demi

Timeline ▾

Recent ▾



Photos



“Na duhet të



Agron Demi

April 4 at 8:28 PM · 🌐

...

Një raportim të kefillë e kam pa vetëm në ngjarjet e marsit 2004. Krejt e mbajmë mend pastaj si patën rrjedhë ngjarjet pas atij raportimi të RTK.

Përveç që i han rreth 12 milionë euro në vit, shantazhon dhe është burim i korrupsionit që krahasohet me PTK, televizioni publik është një ndër rrezikuesit më të mëdhenj të sigurisë publike.

Aman mbyllet dhe në vend të një mediumi publik, krijoni program publik, ku të gjitha mediat tjera mundën me aplikku dhe me transmetu tema në interes të publikut.

+ Add Friend



Follow





Agron Demi Timeline Recent

Add Friend Follow



Life Events



Started New Job at Instituti GAP December 2016



Started New Job at Prishtina Insight April 2016

English (US) · Shqip · Deutsch · Español · Português (Brasil)



Privacy · Terms · Advertising · Ad Choices · Cookies · More · Facebook © 2020



Agron Demi April 5 at 2:39 PM

RTK-në nuk guxojmë me e injor. Edhe pse gjithnjë e më pak e shikojmë, RTK-në gjithnjë e më shumë po paguajmë nga taksat tona.

Një kohë kam avoku për më ndryshu mënyrën e financimit të RTK, me e nxjerr nga buxheti dhe me u financu direkt nga qytetarët ngase kam mendu se kështu mund të nxirret nga kthetrat e partive. Tash mendoj se RTK duhet me u MBYLLË. RTK nuk mund të shpëtohet

Në emër të interesit publik, në dhjetë vitet e fundit RTK ka marr nga taksat tona rreth 100 milionë euro dhe angazhon mbi 1000 punëtorë.

Por, me më pak buxhet e punëtorë, secili medium privat sot na informon më paanshëm politikisht e profesionalisht se sa RTK. Me ma pak buxhet, secili medium privat sot ka teknologji më të mirë të transmetimit se sa RTK. Ngase RTK, ashtu sikurse Posta, është kujdes me punësu familjarë të politikanëve e me i transmetu pa ndërpre konventat e fjalimet bajate të PDK.

Vetëm shiteni edhe një herë raportimin e mbremshëm nga ura e Mitrovicës. Siklelin e gazetares kur bashkëbiseduesi i parë refuzonte me ju përshtatë propagandës së RTK. Mënyra se si RTK mbremë më çdo kusht mardohej me nxitë kaos, ngase kështu po i duhet Presidentit dhe PAN, të cilët janë fajtorët kryesorë pse veru i vendit është kështu qysh është.

Andaj, ku është qëllimi me vazhdu me funksionu RTK?

and 911 others

41 Comments 56 Shares

Like

Share

Most Relevant